



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 37

Datë: 30. 11. 2022. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Vesa Xharra, drejtoreshë u.d., e ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes Nr. 34 dhe 35/2022**
- 3. Aktivitetet e SKQZ-së**
- 4. Raport nga Zyra e ZRCKFSP**

Kufizimi i shpenzimeve për fushatën e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvend Komunal në Leposaviq dhe Zveçan

- 5. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

Këshilli për Operacione Zgjedhore

-Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për ndryshimin e dokumentit të Specifikimeve teknike për shtypjen e fletëvotimeve dhe broshurave

Këshilli për Çështje Ligjore

-Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarit të Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Veriut

- 6. Të ndryshme !**
-

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi: E hapim mbledhjen e 37, mungojnë Rifat Krasniqi, Fazli Stollaj dhe Sami Hamiti, ndërsa të tjerët janë. Kryetari paraqiti rendin e ditës, dhe pastaj anëtarët e KQZ me 8 vota për miratuan rendin e ditës...

Miratohen procesverbalet, nr. 34, dhe 45.

2. Aktivitetet e SKQZ-së:

Burim Ahmetaj, kryeshef i Sekretariatit: Në kuadër të përgatitjeve për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave në Komunitet: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, që do të mbahen me datën 18 dhjetor 2022, janë 2 periudha të cilat kanë filluar. Periudha e aplikimit për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës dhe Periudha e Shërbimit të Votuesve për ndërrimin e Qendrave të Votimit: Periudha e aplikimit për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës !

Bazuar në Planin Operacional për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave në Mitrovicën e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, që do të mbahen me datën 18.12.2022, Periudha e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, ka filluar me datën 26.11.2022 dhe do të përfundojë me datën 30.11.2022. Deri me datën 29.11.2022, kemi pranuar një (1) aplikacion për regjistrim, i cili pas vlerësimit të kriterëve juridike, kërkesa për regjistrim është aprovuar. Aplikacioni është dërguar nga shteti i Gjermanisë, dhe është aprovuar për komunën e Mitrovicës së Veriut.

Kryeshefi Ahmetaj, e informoi KQZ-në me periudhën e Shërbimit Votues për ndërrimin e Qendrave të Votimit që ka filluar më 29.11.2022, dhe përfundon me datën 04.12.2022. Para fillimit të kësaj periudha, the z. Ahmetaj, janë publikuar të gjitha njoftimet në ueb faqen e KQZ-së dhe gjithashtu është publikuar lista preliminare e votuesve në platformën online "Gjeni qendrën tuaj të votimit". Deri në orën 23:00 të datës 29.11.2022, përmes platformës online, është parashtruar vetëm një kërkesë për ndërrimin e qendrës së votimit.

Po ashtu, në raport është pasqyruar edhe progresin në lidhje me përgatitjet për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin Komunal në Zveçan dhe Leposaviq. Ahmetaj, tha se shërbimi votues i SKQZ-së ka pranuar ekstraktin e parë të Regjistrimit Civil nga Agjencia për Regjistrimin Civil, periudha e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës do të fillojë me datë 5 dhjetor 2022, ndërsa periudha e regjistrimit të votuesve me nevoja të veçanta – Kategoria e parë e VPNV do të fillojë me datë 8 dhjetor 2022. Në terren, për Komunitet Zveçan dhe Leposaviq, KKZ-ja do të funksionojë e njëjta e cila është themeluar për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan. Po ashtu programi orientues për KKZ dhe trajnimet e KVV-ve do të zhvillohen për të dy palë zgjedhjet në të njëjtën kohë për Komunitet Zveçan dhe Leposavia.

Bazuar në shkresën e KQZ-se drejtuar Policisë së Republikës së Kosovës, me kërkesë të policisë, sot me datë 30.11.2022, do të mbahet një takim mes SKQZ-së lidhur me Koordinimin në Terren të bashku me Shefat e Operatives nga Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Drejtorisë Rajonale të Policisë në Mitrovicën Jugore, së bashku edhe me ushtruesit e detyrës së ZLKZ-ve të emëruar tashmë nga KQZ !

Takimi në fjalë, do të mbahet në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Mitrovicën e Jugut me ç'rast, do të diskutohet se si të funksionalizohen zyrat e KKZ-ve.

Nga anëtarët e KQZ-së, nuk pati debat lidhur me këtë raport.

3. Raport nga Zyra e ZRCKFSP

Kufizimi i shpenzimeve për fushatën e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvend Komunal në Leposaviq dhe Zveçan:

Vesa Xharra, u.d. e zyrës, tha ë raportin e saj se KQZ është e obliguar që jo më vonë pesë ditë pas shpalljes së zgjedhjeve, të bëjë kufizimin e shpenzimeve të fushatës. KQZ, e përcakton maksimumin e shpenzimeve të fushatës, mbështetur në numrin e përgjithshëm të votuesve të regjistruar në listën e votuesve në kohën e freskimit të fundit të listës së votuesve në dispozicion të KQZ-së.

Zyra për regjistrimin, certifikimin dhe kontrollin financiar të subjekteve politike, ka përgatitur limitin e sipërm të shpenzimeve që vlen për çdo mall dhe shërbim të shpenzuar për qëllimet e fushatës që do të zbatohet nga data 19 dhjetor deri më 23 dhjetor 2022. Bazuar në numrin e banorëve të secilës komunë ku edhe organizohen këto zgjedhje, i cili është siguruar nga Divizioni për shërbimin e votuesve, shpenzimet maksimale të cilat subjektet politike të certifikuar për pjesëmarrje në këto zgjedhje mund ti bëjnë për qëllime të fushatës janë si në vijim:

Komuna e Leposaviqit: 6, 648.5 euro, në raport me 13, 297 votues.

Komuna e Zveçanit: 3, 491 euro në raport me 6,982 votues.

Pra, tha z. Xharra, bëhet fjalë për gjithsej: 10 139.5 dhe ZRCKFSP rekomandon aprovimin e limitit të sipërm për shpenzimet e fushatës për Zgjedhjet e Parakohshme Kuvend të Komunës në komunat Leposaviq dhe Zveçan.

Kreshnik Radoniqi: E hedh në votim...?

Me 8 vota për, miratohet rekomandimi i zyrës për kufizimin e shpenzimeve për fushatën e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvend Komunal në Leposaviq dhe Zveçan:

4. Raport i Këshillave të KQZ-së:

1.Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për ndryshimin e dokumentit të Specifikimeve teknike për shtypjen e fletëvotimeve dhe broshurave:

Arianit Elshani: KOZ-i, sot ka shqyrtuar rekomandimin për ndryshimin e dokumentit të specifikimeve teknike për shtypjen e fletëvotimeve dhe broshurave ! KQZ, ka kohë që këtë proces e kontraktin me një operator ekonomik nga Sllovenia, pra me CETI-s, në pamundësi të tyre për të ofertuar për shkaqe objektive - teknike, ne duhet t'i rishikojmë edhe njëherë specifikat. Në Kosovë, nuk ka operator që plotëson kriteret, pra nuk posedon certifikatë **ISO – “14298”** ! Ne, detyrohemi ti ndryshojmë disa specifika teknike, disa masa të sigurisë, mirëpo kjo nuk e dëmton procesin dhe as fletëvotimin dhe si KOZ rekomandojmë për aprovim kërkesën që, të ketë një ofertim të kompanive nga Kosova.

Në këtë pikë, diskutuan: **Sami Kurteshi, Ibrahim Selmanaj, Alim Rama, Burim Ahmetaj** të cilët, e përkrahen faktin që nëse fletëvotimet mund të prodhohen në Kosovë, i plotësojnë standardet reale të prodhohen në Kosovë. Ndërsa, Ilir Gashi tha se, është ende herët t'i anashkalojmë disa standarde, sidomos besueshmëria e procesit ! Është herët ende, sepse "besueshmëria" kryesore e proceseve zgjedhore, ka buruar pikërisht nga standardi i fletëvotimit se ku janë prodhuar...!

Gordana Llaban: Bash për këtë duhet t'i shtypim atje ku janë shtypur deri tani...!

Alim Rama: Ata, nuk punojnë për momentin...!

Sami Kurteshi: Cilat janë ato elemente të sigurisë që në Kosovë operatorët nuk i kanë, por që i ka operatori në Slloveni...?

Kreshnik Radoniqi: E lamë këtë dhe e diskutojmë një ditë tjetër...?

Lidhur me pyetjen e z. Kurteshi, shpjegoi z. Rama mbi sigurinë e "Fletëvotimit" që, prodhohet në Slloveni.

Kush është për rekomandimin e miratimit të ndryshimit të specifikave...?

Me 8 vota për, miratohet.

2. Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarit të Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Veriut:

Sami Kurteshi: Asht mbajtë mbledhja e këshillit, në mungesë të z. Hamiti e kam kryesuar unë takimin. Kemi qenë aktër anëtarë, dhe kemi shqyrtuar kërkesën për zëvendësim të anëtarit të Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Veriut.

Ne, e kemi dëgjuar zyrën ligjore, e kemi shqyrtuar dokumentacionin dhe, nëse keni pyetje urdhëroni, mirëpo ne kemi një listë emrash. Mendoj që kryesuesi duhet ti lexoj emrat në mënyrë individuale...

Gordana Llaban: I kemi 14 kandidatë, por i kemi pasur 19. Prej këtyre, 17 kanë dhëndë dorëheqje, pra ne "17 njerëz i zëvendësojmë me 14 njerëz" !

Emira Alushi, zyra Ligjore: Arsyeja është se kështu ishte numri, nuk kishte tjerë, deri në "14" ishte numri...!

Gordana Llaban: Po nëse ndonjëri zgjidhet për kryetar, mbeten 13...!

Sami Kurteshi: Nuk kemi të drejtë me ia ndalue askujt kandidimin...!

Kreshnik Radoniqi: Vazhdojmë me zëvendësim të kandidatëve. Atëherë: i dorëhequri Nemanja Bishevac nga subjekti politik Srpska Lista, zëvendësohet me Aida Ferati – Doli nga Iniciativa qytetare "MITROVICA" nga Mitrovica e Veriut.

Kush është për...?

Me 8 vota për, miratohet.

Kreshnik Radoniq: I dorëhequri Ivan Zaporozhac nga subjekti politik Srpska Lista, zëvendësohet me Nexhat Uglaninin nga Iniciativa qytetare "MITROVICA" nga Mitrovica e Veriut.

Kush është për...?

Me 8 vota për, miratohet.

Kreshnik Radoniq: I dorëhequri Dushan Dimitrijeviq nga subjekti politik Srpska Lista, zëvendësohet me Bashkim Cimilin nga nga Iniciativa qytetare "MITROVICA" nga Mitrovica e Veriut.

Kush është për...?

Me 8 vota për, miratohet.

Kreshnik Radoniq: I dorëhequri Ivan Rakiq nga subjekti politik Srpska Lista, zëvendësohet me Gëzim Alushin nga Iniciativa qytetare "MITROVICA" nga Mitrovica e Veriut.

Kush është për...?

Me 8 vota për, miratohet.

Kreshnik Radoniq: I dorëhequri Jovan Stankoviq nga subjekti politik Srpska Lista, zëvendësohet me Erden Atiqin nga Iniciativa qytetare "MITROVICA" nga Mitrovica e Veriut.

Kush është për...?

Me 8 vota për, miratohet.

Kreshnik Radoniq: E dorëhequria Biljana Vukvqi nga subjekti politik Srpska Lista, zëvendësohet me Petrit Miftarin nga iniciativa qytetare "MITROVICA" nga Mitrovica e Veriut.

Kush është për...?

Me 8 vota për, miratohet.

Kreshnik Radoniq: E dorëhequra Gordana Saviq nga subjekti politik Srpska Lista, zëvendësohet me Arben Smajlin nga iniciativa qytetare "MITROVICA" nga Mitrovica e Veriut.

Kush është për...?

Me 8 vota për, miratohet.

Kreshnik Radoniq: I dorëhequri Sinisha Laziq nga subjekti politik Srpska Lista, zëvendësohet me Meleke Kelmendi – Shipoli nga Iniciativa qytetare "MITROVICA" nga Mitrovica e Veriut.

Kush është për...?

Me 8 vota për, miratohet.

Kreshnik Radoniq: I dorëhequri Nebojsa Milanoviq nga subjekti politik Srpska Lista, zëvendësohet me Naxhije Xhemen nga Iniciativa qytetare "MITROVICA" nga Mitrovica e Veriut.

Kush është për...?

Me 8 vota për, miratohet.

Kreshnik Radoniqi: I dorëhequri Ivan Mirijeviq nga subjekti politik Srpska Lista, zëvendësohet me Lumni Xhaken nga Iniciativa qytetare "MITROVICA" nga Mitrovica e Veriut.

Kush është për...?

Me 8 vota për, miratohet.

Kreshnik Radoniqi: E dorëhequra Biljana Vidosavleviqi nga subjekti politik Srpska Lista, zëvendësohet me Jahir Demakun nga Iniciativa qytetare "MITROVICA" nga Mitrovica e Veriut.

Kush është për...?

Me 8 vota për, miratohet.

Kreshnik Radoniqi: I dorëhequri Dejan Gureshiq nga subjekti politik Srpska Lista, zëvendësohet me Aida Betim Osmanin nga Iniciativa qytetare "MITROVICA" nga Mitrovica e Veriut.

Kush është për...?

Me 8 vota për, miratohet.

Kreshnik Radoniqi: I dorëhequri Miodrag Raliq nga subjekti politik Srpska Lista, zëvendësohet me Adelisa Gjyshincen nga Iniciativa qytetare "MITROVICA" nga Mitrovica e Veriut.

Kush është për...?

Me 8 vota për, miratohet.

Kreshnik Radoniqi: I dorëhequri Dragisha Maksimoviq nga subjekti politik Srpska Lista, zëvendësohet me Dushan Millunoviqin nga G.I SRPSKI OPSTANAK nga Mitrovica e Veriut.

Kush është për...?

Me 8 vota për, miratohet.

Sami Kurteshi: Për momentin, ka mbetur edhe zëvendësimi i asamblistëve të Kuvendit të Zubinpotokut. Sapo të plotësohet – kompletohet dokumentacioni, ne do t'i shqyrtojmë në këshillë...

Arianit Elshani: Desha të di nëse ka ndonjë aktivitet të planifikuar gjatë uikendit nga plani operacional që, ne të përgatitemi për javën tjetër...?

Vesa Xharra, u.d. e ZRCKFSP, tha se të premtën mbyllet afati për certifikim të kandidatëve për dy komunat që shkojnë në zgjedhje. Ne, punojmë si zyre për vikend, dhe të martën do të jetë afati për vendim – certifikim, kurse të mërkurën më datën 7 dhjetor, hedhja e shortit...

Sami Kurteshi: Sot dëgjova për një bashkëpunëtor të Sekretariatit që është i sëmurë, në gjendje të rëndë...Ne, e kemi një ligj që edhe nuk lejon ndihmë...! Është fjala për Nexhmiun, dhe ne sinqerisht se çka ngjan me njerëzit e tanë që, kur njeriu ka më së shumti nevojë ata mbesin pa pagë...Kishte me qenë edhe

e ndershme, e mbi të gjitha jo jashtkushtetuese që për njeriun që ka nevojë për ndihmë, me ba një zgjidhje...! Mendojeni, në mbledhjen e ardhshme mendoj që ne duhet me ba diçka për këtë punë...

Ilir Gashi: Le të shikoj Sekretariati se çka mundet me ba, pra gjithçka që është e mundshme me ba që varet prej nesh, natyrisht brenda asaj që lejohet... Shikoni të gjitha mundësitë, e nëse varet nga vendimmarrja jemi dakord...

Sami Kurteshi: Ai, është punëtor i yni, dhe duhet të bëjmë diçka... E ka të drejtën kushtetuese ligjore, pra unë jam i interesuar për mbrojtje institucionale...

Kreshnik Radoniqi: Shohim me Sekretariatit, e gjejmë një mundësi besoj...